



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE**

Nr. _____ Prot

Korçë, më _____. 2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje produkte dhe medikamente, per perdorimin e pushkes per kapjen e qenve endacake ”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Shiringa **33141310-6**
- Produkte farmaceutike **33600000-6**

VLERA E FONDIT LIMIT QË PROKUROHET: 1,300,267 (një milion e treqind mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë PA TVSH.

Autoriteti kontraktor ka llogaritur fondin limit duke marre 3 (tre) oferta nga operatorët ekonomike qe operojne ne treg dhe duke perlllogaritur vleren mesatare te tyre ne perputhje me parashikimet ligjore te nenit 76, paragrafi i pare pika b) ,të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Ndermarrja e Sherbimeve Publike, Bashkia Korçë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022,2023,2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës të parashikuar të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenet 43 pika 2c dhe 55 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogël se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2c dhe nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe

të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Termat e references, sasite, specifikimet teknike janë hartuar nga personat përgjegjes për hartimin e specifikimeve teknike caktuar me urdhrin Nr 243 Prot., date 24.06.2025.

Ato janë si më poshtë:

Nr	Emërtimi i mallit	Njësia	Sasia
1	Bombël CO2. 72 gr (60-80 gjuajtje) për montim tek pushka me ajër të kompresuar CO2	copë	10
2	Shiringë S300, për pushkë me CO2, kapaciteti 3 ml, diametër 11 m, pa ago, për përdorim me ilaç narkotizues	copë	100
3	Ago 2.0 x 30mm, për shiringë pushke me ajër me dimension 11 mm	copë	400
4	Tapa gome sigurie, për mbrojtjen e majës së agos 2.0mm, konfeksion 50 copë	pako	10
5	Kapuc mbrojtës për Shiringë 3ml, me age 2.0mm x 30mm	copë	100
6	Stabilizator specifik për shiringë narkotizuese pushke me ajër CO2-11 mm, ngjyrë të kuqe, konfeksion 5 copë	pako	40

7	Set aksesorësh për përgatitjen korrekte të shiringave narkotizuese. Përfshin: shiringë ajri, shiringë mjekësore për ngarkimin e lëndëve narkotike, gjilpërë për shiringë mjekësore, lidhës çeliku midis shiringave, stilolaps çeliku, kapak sigurie, silikon për shiringa.	copë	2
8	Bashkues çeliku për shiringë 11 mm, nevojitet për përgatitjen e shiringave narkotizuese	copë	3

GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Afatet e ekzekutimit: Nga data e lidhjes së kontratës deri në 31 dhjetor .

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Kontraktuesi duhet të dorëzojë mallrat në përputhje me standartet e kërkuara dhe specifikimet teknike me shpenzimet e tij deri në dorëzimin në vendin e përcaktuar që është magazina e Ndermarrjes së Shërbimeve publike, Bashkia Korçe.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të paraqesin në ofertat e tyre mallrat e kërkuara sipas standartit të kërkuar si më sipër.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

NJËSIA E PROKURIMIT

PËLLUMBESHA NURÇE (KRYETARE)

SOFIA SKLLAVI (ANËTARE)

LILJANA MYRTOLLARI (ANËTARE)